

VENDIM
Nr. 28, datë 22.2.2024

**MBI NJOHJEN E LICENCËS PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE,
LËSHUAR NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, PËR SUBJEKTIN “MONTING” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pikës 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pikës 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen, dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.2.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 594/3 prot., datë 15.2.2024, të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin ‘Monting’ sh.p.k.”

konstatoi se:

- Subjekti “Monting”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 594, datë 7.2.2024, paraqiti kërkesën për njohje të licencës së tregtimit të energjisë elektrike, me numër ZRRE/Li_91/23, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1756_2023, datë 18.8.2023, për subjektin “Monting” sh.p.k.

- Me *e-mail*-in e protokolluar me nr. 594/1 prot., datë 8.2.2024, ERE paraqiti pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës (ZRRE) së Kosovë kërkesën për informacion, në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Në përgjigje, me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 594/2 prot., datë 9.2.2024, ZRRE-ja ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 3, dhe shtojca 1/K e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga ZRRE-ja, pra deri më 17.8.2028.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, me nr. ZRRE/Li_91/23, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin, V_1756_2023, datë 18.8.2023, për subjektin “Monting” sh.p.k., që ka regjistruar në Republikën e Shqipërisë subjektin “Monting”, degë e shoqërisë së huaj.

2. Njohja e licencës, sipas përcaktimeve të pikës 1, do të jetë e vlefshme deri më 17.8.2028.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi